

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA SOLEMNE PLENARE E KUVENDIT TË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 03 DHJETOR 2004**

**SA SVEĆANE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE
KOSOVA, ODRŽANE 03. 12. 2004.GODINE**

DHJETOR – DECEMBAR
2004



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Zgjedhja e Udhëheqësve të Institucioneve Qendrore Qeverisëse të Kosovës

ДНЕВНИ РЕД

1. Избор Руководилаца Централних Институција Самоуправе Косова

AGENDA

1. Election of Leaders of Central Governmental Institutions of Kosovo

TRANSKRIPT

NGA SEANCA SOLEMNE PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 03.12.2004

Seanca plenare solemne u mbajt në Sallën plenare të Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 11,00.

Seancën plenare solemne e kryesoi deputeti - për nga mosha më i vjetër i Kuvendit të Kosovës - akademik Mark Krasniqi (PSHDK).

Bashkëkryesuese Nekibe Kelmendi, deputete e Kuvendit të Kosovës (LDK).

KRYESUESI MARK KRASNIQI:

Të dashur deputetë, kam nderin dhe kënaqësinë që si deputet më i vjetër ta drejtoj Seancën inauguruese të Kuvendit të Kosovës, të dalë nga zgjedhjet e lira dhe demokratike të datës 23 tetor 2004.

(Duartrokitje)

Me këtë rast, që në fillim, iu dëshirojë mirëseardhje dhe punë të mbarë deputetëve të legjislaturës së re.

Njëkohësisht, kam nderin që t'përhëndes dhe t'iu dëshiroj mirëseardhje mysafirëve të nderuar:

- zotit Soren Jesen Petersen, Përfaqësues special i Sekretarit të përgjithshëm të kombeve të bashkuara dhe bashkëpunëtorëve të tij;
- të përhëndes gjeneralin Iv de Kermabo, komandant i KFOR-it;
- të përhëndes shefat e zyrave diplomatike në Kosovë;
- Përhëndes po ashtu edhe udhëheqësit e bashkësive fetare, të nderuarin myftiun Naim Terrnava dhe të nderuarin ipeshkvin Mark Sopi.

Para se të fillojmë me pjesën tematike të rendit të ditës, ftoj Përfaqësuesin special të sekretarit të përgjithshëm të kombeve të bashkuara, zotriun Petersen që t'iu drejtohet deputetëve me një fjalë të rastit.

Urdhëroni zoti Petersen, foltorja është e juaja.

(Duartrokitje)

SOREN JESEN PETERSEN:

(Është transkriptuar nga përkthyesja simultane)

Të nderuar deputetë, zonja dhe zotrinj, mysafirë të nderuar, Ndihem shumë i nderuar që marr pjesë në këtë Seancë inauguruese të Kuvendit të ri dhe ju uroj në zgjedhje që keni pasur.

Më lejoni së pari të falënderoj Qeverinë – të cilin mandat e ka përfunduar, e udhëhequr nga kryeministri Rexhepi për punën që e ka bërë gjatë vitëve të fundit.

Kjo Qeveri ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në ngritjen e çështjeve të rëndësishme për Kosovën, ka bërë përparim të rëndësishëm dhe ka mundur rimëkëmbje pas dhunës së tmerrshme që ka ndodhur në mars.

Zgjedhjet e tetorit që iu kanë sjellur juve këtu, kanë qenë të lira e të drejta dhe janë udhëhequr në mënyrë të qetë. Kjo është meritë e Kosovës. Seanca e sotme është pasqyrim i këtij procesi demokratik.

Si anëtarë të organit më të lartë - përfaqësues legjislativ - të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, ju keni një përgjegjësi shumë të rëndësishme jo vetëm ndaj votuesve tuaj që iu kanë dhënë besimin, por edhe ndaj Kosovës. Ju keni përgjegjësi që të merrni vendime të vetëdijshme të cilat do të jenë në interesin e gjithë Kosovës.

Sapo u ktheva nga Nju-Jorku, ku kam informuar Këshillin e Sigurimit lidhur me situatën në Kosovë, duke përfshirë edhe vlerësimin tonë lidhur me përparimin e bërë deri më tani dhe lidhur me rrugën që gjendet para nesh. Lidhur me këtë, jam i kënaqur që kam fituar mbështetje të fuqishme nga Këshilli i Sigurimit përse i përket strategjisë për të ecur përpara. Kjo don të thotë se ka pritje të mëdha përse i përket aftësisë së Kosovës për të shënuar përparim të vërtetë lidhur me standardet dhe mundësimin e vlerësimin pozitiv të këtyre arritjeve në mesin e vitit 2005 dhe procesin që do të zhvillohet më pas dhe që shkon drejt bisedimeve për statusin. Tani kjo varet prej jush, dhe ju duhet të tregoni rezultate.

Për këtë arsye, UNMIK-u tash është i gatshëm që t'ju mbështesë dhe është me rëndësi që Kuvendi dhe Qeveria të fillojnë të punojnë menjëherë.

Siç e dini, zbatimi i standardeve duhet të jetë prioritet për ju gjatë muajve të ardhshëm, në mënyrë që të sigurohet përparim i duhur para se të bëhet vlerësimi i vitit 2005.

Kuvendi do të luaj një rol kyç në miratimin e ligjeve që është vitale për realizimin e standardeve. Mirëpo, është poaq me rëndësi që procesi legjislativ të realizohet në mënyrë të hapur demokratike dhe të përgjegjshme, në përputhje të plotë me kornizën kushtetuese.

Edhe ky është standard. Kuvendi më parë ka mbajtur seanca të hapura për t'u konsultuar me ekspertë vendës dhe me pjesëtarë të opinionit për legjislacionet dhe çështje të interesit të përgjithshëm. Dhe, unë ju inkurajoj që të vazhdoni me këtë traditë.

Institucionet e përkohshme duhet të jenë në kontakt dhe të kenë mundësi të këmbëjnë qëndrime me opinionin e gjerë dhe të dëgjojë brengat e tyre dhe të veprojnë pastaj në bazë të tyre. Standardet kërkojnë që t'i kenë parasysh shqetësimet dhe opinionet e të gjitha komuniteteve të Kosovës. Për shumë arsye, pjesëmarrja serbe në zgjedhje ka qenë e ulët, mirëpo ende ka vend për pjesëmarrje të tyre aktive në Presidencë apo Kryesi të Kuvendit apo komisionet gjegjëse.

Është përgjegjësi e secilit deputet, jo vetëm e komisioneve dhe organeve të dizejuara, në mënyrë specifike për t'i marrë parasysh interesat e komuniteteve, por është përgjegjësi edhe e të gjithë juve që ta bëni Kosovën një vend më të mirë për të gjithë qytetarët që jetojnë në të.

Siç e dini, UNMIK-u planifikon që t'i transferojë të gjitha kompetencat, jo ato që ndërliken me sovranitetin drejtpërdrejt, dhe ato kompetenca do t'i transferojë tek institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes sa më shpejt që të mundet.

Sikur themelimi i paradokohshëm i tri ministrive të reja: ajo për kthim dhe komunitete, energjetikë e miniera dhe qeverisje lokale, pastaj do të përcillen me ministri të reja, e veçanërisht në fushën e ekonomisë, e ndoshta më pas edhe në fushën e drejtësisë dhe sigurimit.

UNMIK-u dhe institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes duhet të kenë një qasje të përbashkët në përcaktimin e strategjisë më të mirë për transferimin apo bartjen e kompetencave. Mirëpo, bartja e kompetencave ka kuptim vetëm nëse shpie drejt veprimeve produktive dhe pozitive. Kompetencat shtesë nënkuptohen me përgjegjësi më të madhe dhe veçanërisht kur bëhet fjalë për përparimin drejt realizimit apo implementimit të standardeve.

Unë, jam i gatshëm që t'i vë në dispozicionin tim të gjitha veglat dhe masat për përfundimin dhe për fuqizimin e institucioneve të përkohshme. Këto vegla përfshijnë – veglat e monitorimit dhe mbikëqyrjes, mirëpo edhe sanksioneve.

Jam i gatshëm që t'i sfidoj zyrtarët të cilët dështojnë në realizimin e përgjegjësiave dhe të cilët i bllokojnë përpjekjet për të bërë përmirësim në fushat kyçe siç janë të drejtat e pakicave, liria e lëvizjes, kthimi i të zhvendosurve, ofrimi në baza të barabarta të shërbimeve, mediat përgjegjëse dhe siguria.

Unë pres mbështetjen e përhershme të institucioneve të përkohshme në zbatimin e kësaj politike dhe veprimeve. Po ashtu jam i vetëdijshëm se transferimi i suksesshëm i kompetencave ka nevojë për ndërtimin e kapaciteteve shtesë në institucionet e përkohshme. Për këtë arsye, kam marr nismën që të mobilizoj mbështetjen e donatorëve për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes. Dymbëdhjetë muajt e ardhshëm do të jenë vital apo jetësor në përcaktimin e ardhmërisë së Kosovës. Puna e Kuvendit – koalicionit qeveritar, si dhe opozita parlamentare - do të përcaktojnë se a ka sukses Kosova apo jo. Dështimi, nuk është opcion. Vetëm puna e rëndë, veprimet e vërteta dhe përparimi me interes të Kosovës do të merren parasysh.

Ju falemnderit që më keni ftuar dhe ju uroj mandat të suksesshëm dhe produktiv.

KRYESUESI MARK KRASNIQI:

Falënderojmë zotin Petersen për fjalën drejtuar deputetëve të Kuvendit.

Vazhdojmë me procedimin sipas rendit të ditës.

Së pari, më lejoni të konstatoj se në Seancën e sotme janë të pranishëm 108 deputetë, kështu që Kuvendi mund të vazhdojë punën.

Në radhë është zgjedhja e Kryesisë së Kuvendit.

Ju njoftoj se, konform Kornizës kushtetuese dhe Rregullores së punës, Kuvendi zgjedh Kryesinë dhe kryetarin e Kuvendit nga radhët e deputetëve dhe të partive që kanë të drejtë të emërojnë anëtarë të Kryesisë si vijon:

- LDK – dy anëtarë, meqë ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet parlamentare, duke deklaruar se njëri prej tyre do të emërohet për kryetar të Kuvendit;
- PDK – dy anëtarë, si Parti e dytë me numrin e fituar të votave;
- AAK – një anëtar, si Parti e tretë me numrin e fituar të votave;
- Ora – një anëtar si Parti e katërtë me numrin e fituar të votave;

- Një anëtar nga radhët e deputetëve të partive të cilat janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb;
- Një anëtar nga radhët e komunitetit joshqiptar dhe joserb në Kosovë, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre.

Prandaj, sipas kësaj radhe, lus kryetarët e partive t'i propozojnë emrat e kandidatëve për anëtarë të Kryesisë. Pasonjë propozimet e partive dhe le të urdhërojnë kryetarët e partive me radhë. Para se gjithash, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

IBRAHIM RUGOVA:

I nderuari kryesues i Seancës përruruese të Kuvendit të Kosovës, profesor Krasniqi, të nderuar deputetë,

Kam nderin t'ju njoftoj se LDK për anëtarë të Kryesisë propozon akademik Nexhat Daci dhe profesor Fatmir Sejdiu.

Për kryetar të Kuvendit të Kosovës LDK propozon akademik Nexhat Dacin.

Njëherit, ju njoftojmë se shef i Grupit Parlamentar të LDK do të jetë profesor Alush Gashi.

Ju falemnderit.

(Duartrokitje)

KRYESUESI MARK KRASNIQI:

Ftoj kryetarin e PDK t'i paraqesë emrat e propozuar.

HASHIM THAQI:

I nderuari kryesues, Partia Demokratike e Kosovës për anëtarë të Kryesisë së Parlamentit të Kosovës propozon Ramë Bujën dhe Xhavit Halitin, ndërsa shef të Grupit Parlamentar propozon Jakup Krasniqin.

(Duartrokitje)

RAMUSH HARADINAJ:

I nderuar zoti kryesues, të nderuar deputetë,
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës anëtar të Kryesisë së Parlamentit të Kosovës
propozon deputetin Naim Maloku.

Ju falemnderit.

KRYESUESI MARK KRASNIQI:

Ftoj kryetarin e Orës të propozojë anëtarin e Kryesisë së Kuvendit.

VETON SURROI:

I nderuari kryesues, të nderuar zonja dhe zotrinj,
Në emër të lëvizjes Ora propozoj Gazmend Muhaxherin për anëtar të Kryesisë së
Kuvendit. Njëkohësisht kërkojmë nga Grupi Parlamentar i LDK që të emërojë...,
të rishikojë vendimin eventual për kryetar të Kuvendit, duke përzgjedhur një
person të ri. Zoti Daci, me punën e deritashme është dëshmuar si joefikas dhe
përrjashtues. Besojmë se brenda subjektit të LDK ka njerëz të cilët mund të jenë
unifikues të Kuvendit të Kosovës. Ju falemnderit.

KRYESUESI MARK KRASNIQI:

Ftoj anëtarin nga radhët e deputetëve të partive të cilat janë deklaruar se
përfaqësojnë komunitetin serb ta propozojnë anëtarin e tyre. Nëse ende s'e kanë
të propozuar anëtarin, atëherë mund këtë ta bëjnë me një rast tjetër.

SLAVIŠA PETKOVIĆ:

Ja obaveštavam samo Skupštinu da ćemo mi naknadno utvrditi našeg člana.
Možete nastaviti. Kada budemo imali predložen našeg člana i kada budemo
postigli dogovor sa drugom listom tojest „Srpskom listom za Kosovo i Metohiju“
tako da ćete naknadno biti obavešteni. Hvala.

KRYESUESI MARK KRASNIQI:

Ftojmë anëtarin nga radha e komuniteteve joshqiptare edhe joserbe në Kosovë, ta
propozojë anëtarin e tyre.

MAHIR YAGCILAR:

(Është transkriptuar nga përkthyesja simultane në gjuhën shqipe – mungon inçizimi)

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar mysafirë,
Ne kryetarët e tri subjekteve politike KDTP, „Vakat“, IRDK të cilat kanë marrë vota të shumta në zgjedhje, morëm vendim që nga këto tri subjekte, sipas shortit të jetë Xhezair Murati, i dyti Mahir Jaghillar, i treti Bislim Hoti. Kjo marrëveshje do të nënshkruhet nga të gjithë deputetët minoritar. Pra, si tri grupe, ne kemi këtë propozim. Domethënë, propozimi i parë është për Xhezair Murati.

KRYESUESI MARK KRASNIQI:

Do të votojmë edhe për kryetarin e Kuvendit. Ftoj deputetët që me një votim formal, pa debat, të deklarojnë për emërimin e tyre.

Lus shërbimin e Sekretarisë që ta konstatojë prezencën e deputetëve dhe t'i numërojë votat.

Kush është për? Le të numërohen votat ju lutem.

Kësaj radhe, edhe unë do ta çoj dorën, sepse vlenë një votë ngritja e dorës sime.

Mund të shpall se për kanë votuar 99 deputetë.

(Duartrokitje)

Tani të shohim kush është kundër.

Lus deputetët le të deklarojnë kush është kundër. Unë nuk jam kundër.

Kundër janë 7 vota.

Të shkojmë më tutje.

A abstenon kush? Janë tri vota abstenimi, por votat e abstenimit nuk kanë peshë për vendimarrje.

Në bazë të rezultatit të votimit, konstatoj se me shumicë votash Kuvendi miratoi emërimin e kryetarit të Kuvendit dhe të anëtarëve të Kryesisë. Iu urojmë sukses.

(Duartrokitje)

Tani propozoj që ta bëjmë një pauzë prej 15 minutash. Ju falemnderit.

(Vijoi pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën)

(Ndërprerje)

SEANCËN E KRYESON KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI
BASHKËKRYESUES NAIM MALOKU, ANËTAR I KRYESISË SË
KUVENDIT TË KOSOVËS

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,
Në emër të Kryesisë së posazgjedhur dhe në emrin tim personal, ju falënderoj të gjithëve. Në veçanti falënderoj edhe ata që kanë patur mendim tjetërfare sepse kjo tregon që në Kosovë demokracia është në veprim.

Në emër të Kryesisë premtojmë një bashkëpunim të sinqertë, profesional dhe njerëzor, sepse të gjithë jemi të vetëdijshëm që institucionet e reja kanë sfida të rëndësishme numerikisht të bollshme dhe se kërkojnë përkushtim serioz profesional dhe demokratik.

Prandaj, pa humbur kohë, pas këtij falënderimi, ju njoftoj se në pajtim me rregullat e procedurës ftoj përfaqësuesin e Partisë që ka siguruar numrin më të madh të vendeve në Kuvend, pra Lidhjen Demokratike të Kosovës që të paraqesë edhe oficielisht në Parlament emrin e kandidatit për kryetar të Kosovës. Ne e dijme të gjithë kush është, por ftoj kandidatin ta propozojë. Urdhëroni. E ka fjalën zoti Kolë Berisha, nënkryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

KOLË BERISHA:

I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar deputetë,
Lidhja Demokratike e Kosovës për kryetar të Kosovës, në mandatin e ardhshëm, propozon doktor Ibrahim Rugovën, kryetar i deritashëm. Ju falemnderit.

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Për fjalë është paraqitur anëtari i ri i Kryesisë, zoti Xhavit Haliti. Urdhëroni, fjala është e juaja zoti Haliti.

XHAVIT HALITI:

I nderuar kryesues, të nderuar kolegë,
Unë mendoj që, meqenëse po i hyjmë një procedure të rregullt, është dashur Kryesia e posazgjedhur të mbajë mbledhjen e saj, ta bëjë rendin e punës dhe të vendosë për mënyrën e procedimit për zgjedhjen e kryetarit të Kosovës dhe institucioneve tjera.

Sipas Kornizës kushtetuese, partia e cila ka më shumë se 25 deputetë ka të drejtë të ketë edhe kandidatë tjetër dhe mendoj se, akoma pa e shpjeguar procedurën e mënyrës së zgjedhjes së kryetarit të Kosovës, nuk është mirë që të fillojmë kështu seancën. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë dua që në fillim t'ju them se nomenklatura duhet të jetë e saktë si i drejtohemi ndokujt, sepse ajo është „a-ja“ edhe në kulturë, edhe në profesionalizëm. Unë nuk jam kryesues, jam kryetar i Parlamentit të Kosovës. Pajtohem me kolegun tim në Kryesi të mandatit të kaluar dhe të ardhshëm që t'ju shpjegoj se procedura e zgjedhjes së kryetarit të Kosovës, të presidentit të Kosovës do të jetë plotësisht konform Kornizës kushtetuese dhe rregullave të punës. Do të thotë, do të rrespektohet në tërësi procedura e zgjedhjes së kryetarit të Kosovës. Këtu keni të drejtë, zoti Haliti. Por, unë mendova t'i dëgjojmë njëherë propozimet dhe pastaj deputetit t'i informoj mirë.

Prandaj, po ua lexoj. Njoftohen deputetët se zgjedhja e kryetarit të Kosovës do të bëhet me votim të fshehtë dhe se në dy votimet e para kërkohet shumica e dy të tretave të votave të deputetëve të Kuvendit, ndërsa në rrethin e tretë kërkohet shumica e votave të deputetëve që votojnë. Pra, të gjitha përgatitjet procedurale teknike janë kryer konform rregullativave dhe ne mund të procedojmë me punën. Urdhëroni zoti Haliti.

XHAVIT HALITI:

Meqenëse Partia Demokratike e Kosovës ka kandidatin e vet për president të Kosovës, mendoj se nuk mund të futemi as në votim të fshehtë dhe meqenëse ju po thuani se do të bëjmë votimin e fshehtë, unë kërktoj që të shpjegohet – cila është mënyra e votimit të fshehtë, sepse votimi i fshehtë në këtë rast duhet të bëhet votim nominal duke ftuar të gjithë deputetët një nga një dhe nuk po shoh kabinën ku do të votojnë deputetët dhe të bëhet votimi i fshehtë. Aha, po më

duket atje qenka, mirë... dhe as kutitë e votimit ku do t'i fusin votat – një. Dhe dy, mendoj se patjetër, meqenëse ka kundërkandidat për president, duhet të bëjmë debat lidhur me zgjedhjen e presidentit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Emrush Xhemajli, kryetar i LPK, pastaj Numan Baliq.

EMRUSH XHEMAJLI:

I nderuari zoti kryetar i Kuvendit, të nderuar zotrinj deputetë, Më lejoni që në fillim të përbërjes së tashme, Kuvendit të Kosovës t'i dëshiroj punë të mbarë.

Ne jemi të vetëdijshëm se Lidhja Demokratike e Kosovës, sipas rezultateve të zgjedhjeve dhe marrëveshjeve me partnerët e koalicionit - ka fituar të drejtën për të propozuar para nesh kandidatin për kryetar të Kosovës, por mendojmë se kandidatura e zotit Rugova që u paraqit këtu nga zoti Kolë Berisha duhet të bie, për arsye se ai në veprimtarinë e tij nuk është treguar i përgjegjshëm para organeve që e zgjedhin si në vitet e 90-ta para lufte, si gjatë lufte. Si pasojë, ai nuk përfaqësoi dhe nuk përfaqëson unitetin e popullit siç e kërkon ky post. Zoti Rugova dihet se publikisht UÇK-ën dhe forcat politike që kanë qëndruar prapa saj i ka kundërshtuar dhe i ka quajtur në mënyrë të përsëritur - krijesa të Serbisë! Ndërsa, siç dihet - gjithashtu publikisht nga të gjithë ne, gjatë kohës së luftës, zotri Rugova ka takuar kreun e agresionit serb Millosheviqin dhe Millutinoviqin. Njëkohësisht ka kërkuar ndaljen e bombardimeve të NATO-s kundër caqeve serbe në kohën kur këto të fundit kryenin masakra mbi popullin e Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lus, vetëm një moment. Emrush një sekond!

(Ndërprerje e shkurtër)

EMRUSH XHEMAJLI:

... e kryetarit të Kosovës, duke lënë postin partiak për të qenë kryetar i të gjithë neve, ndërsa ai – përsëri preferoi të jetë kryetar vetëm i anëtarëve të LDK. Më 14 tetor 2003 Rugova ka shkuar në Vienë për të biseduar me përfaqësuesit e Beogradit pa e marrë pëlqimin e Kuvendit të Kosovës. Zoti Rugova ka paraqitur... është paraqitur joserioz para përfaqësuesve ndërkombëtar. Atyrë iu

kërkon njohjen formale të pavarësisë së Kosovës në kohën kur edhe për mospunën e tij vendit tonë nuk i është rregulluar dokumentacioni i pavarësisë.

Për arsye të cekura më lartë, unë do të votoj kundër, dhe ju ftoj edhe juve të votoni kundër. Njëherit e ftoj LDK-ën që të paraqet një kandidaturë tjetër. Ju falemnderit për durimin, dhe atyre që i mshuan tavolinave.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem, asnjë debat nuk është i paraparë. Unë desha vetëm Partinë e dytë dhe anëtarin e Kryesisë ta rrespektoj.

Zoti Xhemajli, edhe ju si kryetar i Partisë së rëndësishme ua dhash fjalën! Do të thotë, më duhet t'ia jap fjalën edhe Baliqit, si kryetar Partie, por jo të bëhet debat ju lutem, sepse atëherë duhet të gjithë deputetët të diskutojnë dhe kjo nuk parashihet në rend dite. Prandaj, pasi nuk e kemi në rend dite këtë për debat, ju lus ta rrespektojme rregullën. Baliq, ua dhash fjalën. Urdhëroni, dhe vetëm ju.

NUMAN BALIĆ:

Bismilaha rahmane rahim!

Ja naravno da neću moći da kažem sve u dvije rečenice s obzirom da je namjera da napustim sjednicu današnjeg Parlamenta, tako da imam namjeru da kažem nekoliko riječi a da je nemoguće da kažem samo kao repliku, gospodine predsjedavajući.

KRYETARI I KUVENDIIT NEXHAT DACI:

Unë ju thash, ju lutem – si kryetar Partie, shkurt ose ju miret fjala. Urdhëro.

NUMAN BALIĆ:

...Ja vas molim da mi dozvolite tri minuta, i ne želim da... ne želim da kvarim atmosferu i želim da čestitam narodu Kosova na institucijama i te institucije će uvijek imati našu podršku i mi smo se borili, i ja sam se borio, i dalje ćemo se boriti za ove institucije, ali moram da kažem na neke neregularnosti koje se tiču drugih zajednica – Bošnjaka, Roma, Egipćana, Haškalije i tako dalje. To je jedan od standarda, gospodine predsjedavajući, i zadatak buduće Vlade je upravo ispunjenje tih standarda.

Mislim da kod malopredjašnje diskusije, kada je bilo u pitanje Predsedništvo, izabrani su za člana Predsedništva predstavnici a da uopšte nisu konsultovani niti predstavnici Bošnjaka, oprostite govorim za Bošnjake iz SDA, niti su konsultovani predstavnici Haškalija, Roma i prema tome i Goranaca. Dakle,

najmanje četiri zajednice nisu uopšte konsultirane, prema tome to je ono što bih ja mogao nazvati omalovažavanjem, zaobilaženjem ili čak diskriminacijom.

U slučaju ovih stvari koje se tiču formiranje Vlade, ja želim da kažem da nama je osnovni cilj da spriječimo omalovažavanje i zapostavljanje drugih zajednica. Ono što je prethodna Vlada započela, i što se desilo prije dvije godine, a to je gruba zamjena, sada se ne smije dozvoliti. Ja mislim da je zadatak ovoga sastava i ovih institucija da to spriječe. I želim da kažem, vidim da ima mnogo onih nezadovoljnih, ja ću biti veoma kratak a imao sam namjeru da govorim duže, ali

(Pas nderhyrjes – pa kyçje të mikrofonit)

Ne, ja je ne zloupotrebljavam... Hoću da kažem nešto što je veoma važno. Vama se obraća jedan od najvećih prijatelja Kosova, koji je svoj život dao za ovu zemlju, vi samo mislite o svojim brigama, vi samo mislite o svojim interesima i ovde je bitno da se namelju neki sopostveni interesi. Mi podržavamo ove institucije, ali onaj dio koji se tiče prava drugih zajednica, a to je omalovažavanje i zapostavljanje tih zajednica, to ne možemo nikako da podržimo. Bila je jedna kampanja i protiv SDA i protiv Numana Baljića koja je trajala 24 mjeseca, i nije se niko našao da zaštiti nas.

I druga stvar. Da završim, biću vrlo kratak. Moja najkonkretnija primjedba odnosi se na prijedlog koji će se odnositi za ministra zdravlja Kosova. Ja ne mogu to da prihvatim nikako, jer je to smiješan prijedlog....

(Nderprerje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Të lutem përfundoje se s'po dua ta marr fjalën. Nuk është debat. Urdhëro.

NUMAN BALJIĆ:

E kam vetem edhe nje minut dhe e perfundoj. Ja ne znam da li vi ne znate, ja znam, kao što i vi takodje znate. Ja ne mogu da dozvolim, i neću učestvovati u onome zbog čega će nam se smijeti cijelo Kosovo – da za ministra zdravlja, koja je pred agonijom, koja je u kolapsu i za koje su odgovorne upravo ove institucije – da se imenuje čovek koji je učitelj i koji može pripadati sektoru obrazovanja a ne Ministarstvu zdravlja. Ovo je naravno i poziv i isvim zdravstvenim radnicima da ne prihvate tu odluku i mi ćemo se protiviti...

(Nderprerje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mos ofendo. Mos i ofendo njerëzit sepse as emrat ende s'i kemi bërë, të lutem. Kam rrespekt, por përfundoje.

NUMAN BALJIĆ:

Dakle, mi neçemo prihvatare i neçemo učestvovati ni u çemu onome što nije dobro i biçemo ovde samo onda kad ovaj Parlament i ove institucije dokažu da rade za dobro i Albanaca, i Bošnjaka, i Roma i svih ostalih i naravno za dobrog sistema zdravstva i svega ostaloga. U protivnom, mi neçemo uzeti učešće u ovim institucijama i ja napuštam sjednicu Parlamenta.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zoti Thaqi, si kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës.

HASHIM THAQI:

I nderuari zoti kryetar i Parlamentit, të nderuar deputetë, të nderuar përfaqësues të zyrave diplomatike – të KFOR-it, të nderuar ju të pranishëm, ju përshëndes në emër të Partisë Demokratike të Kosovës sot në këtë Seancë solemne për ndërtimin e institucioneve të reja të Kosovës.

Uroj që në këtë mandat, ky Parlament të jetë Parlament i debatit, i alternativave, i debatit që do të përshpejtojë ndërtimin e rendit demokratik, të institucioneve shtetërore të Kosovës, një vend ku do të kemi debat konstruktiv dhe - mbi të gjitha – lejim të fjalës së lirë. Uroj që kjo të ndodhë, dhe shpresoj se do të ndodhë. Nuk do të përsëritet e kaluara.

Të nderuar të pranishëm,

Kohë më parë u mbajtën zgjedhjet e lira të katërtat me radhë e të dytat të përgjithshme. Sot, unë – Partia Demokratike e Kosovës, institucionet dhe qytetarët e Kosovës ndihen të hendikepuar që në ulëset e Parlamentit të Kosovës nuk është i ulur shefi i Grupit Parlamentar të PDK-ës Fatmir Limaj. Ne çmojmë lartë punën dhe angazhimet e zotit Limaj për ndërtimin e institucioneve demokratike. Çmojmë lartë bashkëpunimin e tij me autoritetet e drejtësisë ndërkombëtare, ndërsa populli i Kosovës dhe institucionet besojnë plotësisht në pafajësinë e tij. Zoti Limaj do të duhej t'i kthehej familjes së tij dhe institucioneve të Kosovës ku edhe e ka vendin. Besojmë se kjo do të ndodhë.

Procesi zgjedhor u zhvillua sipas standardeve më të larta evropiane. Pjesëmarrja e qytetarëve të Kosovës ishte e njëjtë me nivelin e vendeve tjera të demokracive në transicion. Duke vlerësuar me vëmendje pjesëmarrjen aktive të grupeve etnike

joserbe, përfaqësimit të tyre në institucionet e ardhshme – është i meritueshëm dhe shumëdomethënës për të ardhmen e Kosovës. Abstenimi i serbëve, për qytetarët e Kosovës nuk e humb kuptimin multietnik të zgjedhjeve. Respektimi dhe mbrojtja e minoritarëve në Kosovë për Kosovën është një ndër faktorët kryesor për suksesin tonë të ardhshëm dhe institucionet e reja të Kosovës.

Të nderuar të pranishëm,

Është mjaft me rëndësi për ne dhe sukses i madh që verdikti i qytetarëve u pranua dhe rrespektua nga të gjitha formacionet pjesëmarrëse në zgjedhje. I gjithë procesi, nga qendrat e politikës vendosëse ndërkombëtare, u vlerësua lartë. Rol aktiv dhe pozitiv në menaxhimin, sigurinë dhe organizimin e suksesshëm të zgjedhjeve patën edhe mekanizmat ndërkombëtar të instaluar në Kosovë - UNMIK-u, KFOR-i dhe OSBE, për çka edhe iu shprehim mirënjohje më të lartë dhe falënderime.

Të nderuar deputetë dhe pjesëmarrës të tjerë,

Partitë politike dhe qytetarët e Kosovës realizuan një nga standardet më të rëndësishme demokratike. Ata dëshmuar se janë të aftë të marrin përgjegjësinë vetë për ndërtimin dhe organizimin e zgjedhjeve të ardhshme. Por, e gjithë kjo do të varet nga formula dhe përmbajtja e ndërtimit të institucioneve, kapaciteti, dinamika dhe efektiviteti qeverisës. Për këtë, më herët kisha propozuar projektin për afatizimin e zgjidhjes së statusit politik dhe ndërtimin e unitetit qeverisës për shtetin e Kosovës. Koha që kisha propozuar unë dhe Partia Demokratike e Kosovës ishte pranvera 2005 e që do të duhej të ishte fundi i fillimit të zgjidhjes së statusit politik. Logjika e refuzimit të ideve politike e tjera bëhej që të ndodhin keqkuptime, ndodhi vazhdimi i statuskuos – i dhembshëm për Kosovën dhe qytetarët e saj. Koha, realiteti dhe bota perëndimore, na dha të drejtë, me gjasë – statusi do të fillojë të zgjidhet kah mesi i vitit 2005. Por, edhe kjo varet nga shumë faktorë.

Parimisht, Partia Demokratike e Kosovës dhe unë – si lider i kësaj qendre politikëbërëse në Kosovë, jemi përcaktuar në favor të ndërtimit të institucioneve me bazë të gjerë politike, përfaqësim të partive kryesore politike shqiptare dhe përfaqësim shumëetnik. Ky solucion qeverisës do të ishte solid dhe adekuat për aktualitetin dhe perspektivën trivjeçare kosovare.

Prej sot, Kosova, në kuptimin politik, qytetar dhe në raport me komunitetin ndërkombëtar – duhet të ketë një fillim të ri. Fillimi i mbarë do të nënkuptonte vetëvetiu vazhdim të suksesshëm të procesit, ndërsa fillimi i paqartë – pas pak kohe: paraqitje të krizës institucionale, politike, sociale e të sigurisë.

Është me interes që komuniteti ndërkombëtar po përcjell nga afër ndërtimin e institucioneve, por është edhe me rëndësi që ndërkombëtarët të rrespektojnë të drejtën e kosovarëve që ata vetë të zgjedhin mundësinë më të mirë të qeverisjes

demokratike dhe bartësit e institucioneve. Këtë ata edhe e bëjnë, dhe iu jemi mirënjohës. Ndërsa, ne vendorët kemi për obligim që mos t'i befasojmë miqt me zgjidhje jokredibile, friksuese e jokooperuese për dhe me mekanizmat ndërkombëtar.

Uroj që të kuptohet drejt oferta e sinqert për ndërtim të institucioneve me bazë të gjerë përfaqësuese për realizimin e interesave madhore të vendit dhe qytetarëve. Kjo formulë do të ndikonte edhe më tepër në relaksim të raporteve qytetare, punën më të mirë të institucioneve dhe natyrisht edhe në ngadhënjimin e demokracisë qytetare por edhe përmirësimin e raporteve ndëretnike. Kjo formulë politike, Kosovës do t'i jipte kuptimin e vendit më stabil, me institucione më kompetente, me siguri më të madhe për bashkimin e Mitrovicës, për deenklavizimin e Kosovës, për thellimin e reformave të pushtetit lokal, për zbardhjen e fatit të të zhdukurve, për Trupat Mbrojtëse dhe Shërbimin Policor më me autoritet, vendosmëri më të madhe për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Kjo do të përshpejtonte përmirësimin e gjendjes sociale të qytetarëve sepse, për fat të keq, ne vazhdojmë të mbetemi vendi më i pazhvilluar dhe me numrin më të madh të të papunëve në Evropë. Kjo do të ndikonte në hapjen e vendeve të reja të punës; interesim më të madh për qytetarët tanë në diasporë. Kjo formulë për ndërtimin e institucioneve do t'i sillte imazh më të mirë vendit, do t'i evitonte lajmet e këqia për Qeverinë e re në mediat prestigjioze botërore, do të garantonte bashkëpunim më të mirë me qendrat vendosëse të politikës ndërkombëtare, përfaqësim të merituar në Bruksel, Nju-Jork e gjetiu, bashkëpunim më të mirë me fqinjët e Kosovës, më tepër siguri për investitorët e huaj, implementim më të shpejtë e të sigurtë të kriterëve politike, ekonomike dhe legjislativ si parafazë për zgjidhjen e drejtë të statusit politik. Por, mbi të gjitha, do t'i sillte unitetin kombëtar, politik e qytetar të domosdoshëm për periudhën nëpër të cilën po kalojmë si vend dhe popull.

Kjo zgjidhje, do t'u hapte perspektiv për sukses, do të kthente shpresën, optimizmin dhe besimin tek qytetarët së më në fund po fillon zgjidhja reale e problemeve të tyre për një jetë më të sigurtë e më të mirë në Kosovën e re.

Ndokush mund të thotë se Kosovës i duhet opozita. Pajtohem plotësisht. Por, sot, mbi të gjitha, vendit e qytetarëve i duhet sukcesi. E sukcesi arrihet jo me logjikë përjashtuese, diferencuese e përçarëse, por me qeverisje të unitetit, për shtetin e pavarur – sovran e të integruar të Kosovës në strukturat Veriatlantike.

Të nderuar të pranishëm,

Veprimet eksperimentale për ndërtimin e institucioneve nuk janë shpresë për sukses. Përkundrazi, hapin dilema të reja. Nuk janë shpresë as për të mirën e qytetarëve e as për angazhimet e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë. Kosovës së re i duhen institucionet e reja që punojnë për integrim e akses që e izolojnë Kosovën. Duhet kuptuar se egoja e madhe për pushtet mund të shtyjë të bërit e

shtetit të Kosovës dhe ndërtimit të rendit demokratik. Përvojat e të tjerëve tregojnë se vendet e ndryshme, në momente kyçe e të vështira, për interesa madhore - kanë arritur konsensusin nacional dhe kanë patur sukses. Kjo ishte edhe objektiva kryesore e jona. Por, kemi edhe përvoja kur nga logjika përjashtuese e pozitës, vendet janë futur në kriza të thella, e që nuk i ka kushtuar vetëm pozitës por të gjithë qytetarëve.

Partia Demokratike e Kosovës do të jetë opozitë reale e ofertës dhe e alternativave. Megjithë logjikën diferencuese të pozitës, ne do të punojmë që t'i gjejmë pikat e bashkëpunimit e jo të konfrontimit. Dhe nëse dje Partia Demokratike e Kosovës ishte model i bashkëqeverisjes, në krye me zotin Rexhepi, sot ne do të jemi shembull i opozitës për partitë politike se si duhet të sillen në procesin demokratik të rotacionit pozitë-opozitë.

Ne, në Partinë Demokratike të Kosovës, do të investojmë të gjithë potencialin kombëtar, politik dhe intelektual për qeverisjen e mirë të Kosovës, për ndërtimin e shtetit të Kosovës dhe promovimin e demokracisë qytetare. Falemnderit. Urime, suksese dhe punë të mbarë të gjithëve.

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zoti Thaqi, ju falemnderit. Fakti se opozita sot kishte 98% të kohës së deritashme, pozita vetëm 2% në shfrytëzim, tregon për përcaktimet edhe të pozitës edhe të opozitës për bashkëpunim në çështje fundamentale. Ju falemnderit.

Fjalën e ka krytari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Ramush Haradinaj. Urdhëroni Ramush.

RAMUSH HARADINAJ:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,
Ne të gjithë jetojmë në Kosovë dhe po ashtu ne të gjithë e dijme se çfarë po bëjmë në institucione dhe çfarë po bëjnë partitë politike.

E mendova se është me dobi t'ju shpjegoj se në bazë të rezultatit të zgjedhjeve dhe të vendimit të partive demokratike të Kosovës që kanë marrë pjesë në zgjedhje – është arritur një marrëveshje për koalicionin qeverisës. Përpos zgjedhjeve të suksesshme, marrëveshja është arritur krejtësisht nga vendorët, që mendoj se është edhe një hap më tej që të dëshmojmë vetëbesimin tonë. Marrëveshja kishte edhe pjesë që shpjegonte mënyrën e votimit. Me qëllim që të rrespektojmë procedurat në Kuvend dhe të dëshmojmë përkushtimin tonë për

seriozitet në punë, ne kemi arritur në momente në seancën e Parlamentit se kur do të vazhdojmë me rendin e ditës. Ajo që do të thosha me këtë rast është se të gjitha opinionet që i kemi veç e veç, dhe të gjitha qëndrimet që i kemi veç e veç do të kemi ditë dhe momente kur do t'i bashkojmë për Kosovën, ndërsa po ashtu nuk do të ndalemi në përcaktimin për të qeverisë me Kosovën në shërbim të të gjithë qytetarëve, jo vetëm të atyre që na kanë dhënë besimin. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Dhe, përnga rrespekti, sepse është pas shumë kohësh i pranishëm, zoti Petković, urdhëroni e keni fjalën. Mirë se keni ardhur në Parlament edhe si përfaqësues i etnisë tuaj, edhe si deputet i ri.

SLAVIŠA PETKOVIĆ:

Pošto sam pažljivo saslušao izlaganje gospodina Tačija i gospodina Haradinaja, moram samo da skrenem pažnju na nešto. Ako pričamo o demokratskim procesima na „Kosovu i metohiju“ znate, ne možete da sprovedete demokratske procese a da vam nedostaje 250 hiljada stanovnika „Kosova i Metohije“, u ovom slučaju Srba, koji su već pet i po godina, znači – raseljeni van svojih domova. Znači, ako je to demokratija, onda se mi ne razumemo baš najbolje.

Ni u jednom, ni u drugom izlaganju... a ja se nadam kada gospodin Haradinaj, kada bude postao premijer u svom izlaganju programa Vlade nači jedno mesto i da vidimo na koji način će ti ljudi da se vrate svojim kućama.

Ja se slažem sa gospodinom Tačijem da ne treba praviti enklave na Kosovu, ali isto tako nisam čuo ko će garantovati bezbednost stanovnicima „Kosova i Metohije“... Opet kažem, pošto sam ja... zastupam Srpsku zajednicu, interesuje me znači prvenstveno bezbednost Srba a posle na bezbednost svih, znači svih zajednica na „Kosovu i Metohiji“.

Prošli saziv Parlamenta nije učinio ništa, apsolutno ništa po tom pitanju. Ja se nadam, u stavari hoću da se nadam da će ovaj saziv Parlamenta i buduća Vlada koja će biti sastavljena smoći snage da kaže jasno i glasno – znači ko će biti... Prvo, mora da pokaže volju i onda mora da kaže ko će biti odgovoran ako se 250 hiljada stanovnika, opet kažem u ovom slučaju Srba, ne vrati tamo odakle otišlo; ako se njihove kuće, njihova imanja ne vrate u prvobitno stanje; ako se uzurpirana imovina ne povrati, uzurpirana zemlja, firme i tako dalje, i tako dalje.

Ja mislim da bez toga, ako to ne budemo imali, ja mislim da od demokratije nećemo imati ni „d“. Znači, ja hoću da radim u interesu, znači prvenstveno svoje

zajednice, to je normalno, hoću da saradjujem, ja nisam došao ovde da vršim opstrukciju nikome. Ali, isto tako, znači isto tako – neću, znači neću dozvoliti da u budućem programu Vlade ne stoji, znači da vidimo, pošto p rošla Vlada nije imala tačno - taksativno navedeno - za šta je odgovorna i za šta nije. Nije bila odgovorna za ništa zato što je cela Skupština bila član Vlade. Meni je drago, ako će ova Skupština imati sada opoziciju, koja će – opet kažem – bilo bi dobro da je konstruktivna i da počnemo te probleme da rešavamo, jer ja ne vidim kako vi mislite kako i standardni započnu u opšte kada – kažem opet – na „Kosovu i Metohiji“ nedostaje 250 hiljada stanovnika, opet kažem – slučajem Srba.

Znači ja vas molim, ja apelujem na vas da to uzmete vrlo ozbiljno u obzir i da sednemo, kada za to dodje vreme, i da vidimo šta je plan i program, ko će rukovoditi planom i programom i ono što će mene prvenstveno zanimati – ko će biti odgovoran za to ako se to ne desi, u stvari ako se ne desi ono što se tada budemo dogovorili. Hvala lepo.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Falemnderit. Dhe, fuqia e katërtë në Parlament, zoti Surroi dhe përfundon. Do të vazhdojmë procedimin sipas procedurës. Urdhëroni zoti Surroi.

VETON SURROI:

I nderuari kryetar, të nderuar zonja dhe zotrinj,
Një fjalë e cila nuk është programore, por më shumë sugjeruese. Zgjedhja e krytarit të Kosovës është një privilegj që na jipet sot dhe është një rrjedhë e një procesi demokratik i cili mund të quhet shembullor në tërë rajonin.

Unë përgëzoj Lidhjen Demokratike dhe zotin Rugova për kandidimin e tij në këtë post.

Po ashtu do të përgëzoja PDK-ën për kandidimin e tyre, ndonëse ende s'e kemi dëgjuar emrin e kandidatit, por në çdo rast e përgëzoj procedurën e kandidimit si të tillë.

Duke pasur rëndësinë e këtij kandidimi, duhet të elaboroj shkurtimisht një kërkesë të thjeshtë. Ajo është, që kandidatët për kryetar t'na paraqesin vizionin e punës së tyre të ardhshme-trevjeçare; që kandidatët të na bindin se puna e tyre do të jetë e drejtuar në përmbushjen e obligimeve të Kornizës kushtetuese, të cilën - fundi i fundit - këto subjekte e miratuan dhe nënshkruan.

Në këto qëndrime, jo vetëm deputetët e Parlamentit të Kosovës, por edhe populli i cili e përcjell këtë debat, do të duhej të binden mbi ofertën e cila ekziston nga

kandidati për kryetar dhe në asi rasti edhe neve deputetët t'na e lehtësonte punën në votim.

Grupi Ora nuk ka ndërmend të pozicionohet amblllok as në këtë e as në raste tjera. Nuk kemi ndërmend të votojmë për ose kundër vetëm pse jemi në opozitë. Dhe, për të mbrijtë një cilësi të re të komunikimit mes pushtetit dhe opozitës, do të kërkonim që të hyjmë në procedurë ofertuese nga ana e kandidatëve për kryetar. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI.

Ju falemnderit shumë, zoti Surroi. Me qëllim të procedimit me votim të fshehtë për zgjedhjen e kryetarit të Kosovës, Sekretaria e Kuvendit, me mbështetje profesionale të OSB-esë ka bërë përgatitjet administrative dhe teknike, duke siguruar Komisionin votues prej tre zyrtarëve të Departamentit ligjor; regjistrin e deputetëve të pranishëm për votim; fletëvotimet; kutinë e votimit dhe vendvotimin. Ndërsa, subjektet politike mund të caktojnë nga një deputet për të vëzhguar – monitoruar procesin e votimit dhe të numërimit. Prandaj, do të shkojë çdo gjë konform Kushtetutës dhe procedurave. Është lajmëruar për fjalë zoti Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar.

JAKUP KRASNIQI:

Zoti kryetar, zonja dhe zotrinj deputetë, mysafirë të nderuar, Partia Demokratike e Kosovës shfrytëzon të drejtën e saj për të propozuar kundërkandidatin për postin e presidentit të Kosovës. Pse Partia Demokratike e Kosovës propozon kandidatin e saj? Për t'i dhënë kuptim zgjedhjes së presidentit dhe demokracisë. Jemi të bindur se Kosova po hyn në procese të ndërlikuara politike, a ndaj nga presidenti i Kosovës kërkohet vendosmëri, energji pozitive, kthjelltësi politike dhe intelektuale, kualitete të larta morale dhe kombëtare.

Kandidati ynë është njeri me veprimtari të gjatë politike dhe atdhetare që nga mosha e tij e re. Ka qenë veprimtar i dalluar i aktivitetit ilegal atdhetar, i burgosur politik, pjesëtar aktiv i rrezistencës aktive paqësore, si dhe i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe anëtar i Shtabit të përgjithshëm të UÇK. Në asnjë kohë të jetës së tij nuk i është nënshtruar a gjuhëzuar udhëheqësve shtetëror të okupatorit e as udhëheqësit kriminel të luftës dhe të njerëzimit – Slllobodan Millosheviqit, njeriut që i hapi shumë plagë dhe vështirësi Kosovës.

Kandiati ynë, në asnjë rast dhe në asnjë kohë nuk ka qenë përçarës i jetës politike, as në kohën e rrezistencës paqësore aktive e pasive dhe as në periudhën e luftës çlirimtare dhe pas saj, por është person stabil dhe komunikues i përshtatshëm edhe me kundërshtarët e tij politik.

Kandidati ynë nuk është kandidat i përfolur në gazetari dhe publicistikë, nuk posedon pasuri të padeklaruar a të uzurpuar dhe, në kuptimin më të mirë të fjalës – është personalitet unifikues në jetën politike institucionale, ashtu siç i duhet Kosovës sot.

Kandidati ynë do të rrespektojë rendin dhe ligjin. Nuk do të mirret me simbolikat e kota dhe veprimet tjera të paligjshme, nuk do të luajë me simbole kombëtare, nuk do të partizojë në ekstrem administratën e presidentit, nuk do të shpërndajë deklarata a çmime tjera të paverifikuara për njerëz me apo pa biografi. Administrata e presidentit duhet të jetë pasqyrë e realitetit të Kosovës dhe pasqyrë e unitetit të saj.

Kandidati ynë do ta njehë e do të bashkëpunojë me koalicionin qeverisës dhe me të gjithë liderët politik të Kosovës saherë që kërkon interesi i atdheut. Ai do të raportojë para Kuvendit të Kosovës ashtu siç e parasheh Korniza kushtetuese. Do t'i ushtrojë të gjitha kompetencat e përgjegjësitë e tij – gjithnjë në shërbim të Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Kandidati ynë, gjatë gjithë aktivitetit të tij politik, veprimtarisë së tij politike, para dhe pas luftës çlirimtare, nuk ka nxjerrë në plan të parë pasurimin individual për ndërtim të ndonjë pallati luksoz, siç kanë bërë shumë bashkohanikë të tij pas luftës çlirimtare apo drejtues tjerë të institucioneve më të larta të Kosovës.

Kandidati ynë është personalitet me biografi të pastër si loti, ngado që ta merrësh.

Prandaj, Kosovës, në këtë kohë, pa status politik të definuar i duhet një personalitet me kualitetet që i posedon zoti Ramë Buja, nga Bujani i Lypjanit.

Ramë Buja, ka të kryer fakultetin filozofik – gjuhën dhe letërsinë shqipe, fakultetin ekonomik dhe është magjistër i shkencave juridike. Gjatë viteve të 80-ta është marrë me veprimtari politike atdhetare ilegale, ka qenë i burgosur politik, veprimtar aktiv në vitet e rrezistencës paqësore aktive dhe pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, anëtar i Shtabit të përgjithshëm të saj, anëtar i Delegacionit të Kosovës në Rambuje, ministër i pushtetit lokal në Qeverinë e përkohshme dhe tani deputet në Kuvendin e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Është në nderin tuaj dhe të Kosovës që votën tuaj ta jepni për kandidatin tonë për president të Kosovës zotin Ramë Buja. Është momenti i duhur që Kosova ta ketë një kandidat që bashkon popullin shqiptar dhe gjithë qytetarët e Kosovës. Është njeri që detyrave iu qaset me përgjegjësi dhe përkushtim dhe zgjedhja e tij president të Kosovës do t'ju nderoj ju dhe të gjithë qytetarët e Kosovës.

Ju ftoj, të nderuar deputetë, që votën tuaj ta jepni për kandidatin e Partisë Demokratike për president zotin Ramë Buja.

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ne do ta rrespektojmë plotësisht normën kushtetuese dhe unë mendoj se ndaj qind-përqind mendimin e koalicionit të formuar politik për qeverisje se nuk do të merremi kurrë me ofendime të kandidatëve të partive tjera a të grupacioneve. As nuk kam arsye dhe as që do të mirrem me atë.

Prandaj, ju lutem vazhdojmë me procedimin dhe pas votimit të parë, ne ndoshta do të detyrohemi ta ndërrojmë procedurën, por do të konsultohemi, sepse në qoftë se ka më tepër se një kandidat, unë po ju them para votimeve le të mendohet mirë sepse është demokracia në veprim të plotë, dhe në qoftë se njëri kandidat fiton më tepër se tjetri apo fiton më tepër se 50% të votave – mendimi im personal është që duhet ta shpallim kryetar të Kosovës.

Ju falemnderit. Kalojmë në procedim. Mendoni mirë secili. Po ju them se do të konsultohemi...

(Ndërhyrje – pa kyçje të mikrofonit)

Mirë, ju falemnderit. Unë po ju them se çka na pret të gjithëve dhe do ta shohim rezultatin.

Zoti Koci, shumë libra e fletore kemi pa. Mbaje për veti, prandaj ta ndjekim tash procedurën. Lus Sekretarinë le ta përcjellë procedurën. Lus deputetët që sipas ftesës nga regjistri që do t'i ftoj – nga dy deputetë do të marrin pjesë në procesin e votimit.

Prandaj, ftoj:

- Afrim Arzullaxhiun dhe Agim Krasniqin.

Do të thotë, shkojmë me radhë alfabetike dhe jo ndryshe.

(Pas ndërhyrjes)

Ju lutem, po japim 10 minuta pauzë deri sa të rregullohet lista dhe të futen të dy kandidatët: nën një kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe nën dy kandidatit i Partisë Demokratike të Kosovës.

(Vijoi pauza)

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ftoj të gjithë deputetët t'i zënë ulëset e veta, sepse po hyjmë në proces të votimit. Do t'ishte më mirë të presim edhe pak që të kthehen të gjithë deputetët.

Ju lutem një shpjegim të thjeshtë. Deputetët që i thërras të marrin pjesë në votim, do të marrin nga një fletëvotim prej Sekretarisë dhe do të shkojnë vetëm sipas radhës së ftimit. Po vazhdojmë.

- Afrim Arzullaxhiu dhe Fagim Krasniqi, të dalin për të votuar, ju lutem.

(Ndërkohë votojnë deputetët e ftuar një nga një – dy përnjëherë)

Unë e theksova, subjektet politike që participojnë në Kuvend, emërojnë ose zgjedhin një kandidat që ta monitorojë krejt procesin prej votimit, numërimit dhe të gjitha fazat. Këtë e lexova unë, Xhavit. Nuk është çështje e Kryesisë së punës ose e kryesuesit. Unë e lexova dhe patëm pauzë, kurse pauza u dha pikërisht për t'u përgatitur teknikisht dhe partitë ta caktojnë kandidatin e vet.

(Ndërhyerje)

Po ju propozoni nga partitë tuaja! Atëherë, propozoj nga LDK – Lulzim Zeneli.

(Propozohen kandidatët për vështrim të zgjedhjeve – prej vendi)

- Nga PDK? – Gani Koci.
- Nga AAK? – Gjylnaze Syla.
- Nga Ora - ...

Urdhëroni Mahir. Gjashtë plus dhe grupet parlamentare tjera s'kanë propozuar, por mund këtë ta bëjnë të gjitha partitë e pranishme në Parlament, për t'mos u diskriminue.

A e kryen votimin këta të dy që i ftova? Ju falemnderit. Më tregoni kur ta kryeni, që t'i thërras dy tjerët për votim.

Ju të komisionit - përcillne punën si duhet.

- Ahmet Isufi dhe Alush Gashi.
(Votojnë)
- Le të bëhen gati Arsim Bajrami dhe Bajram Kosumi. Arsimi s'është, sepse mungon.
- Atëherë Bajram Kosumi dhe Bajram Rexhepi.
(Votojnë)
- Bajrush Xhemajli, Baliq Numan. S'është Baliqi.
- Behxhet Brajshori.
(Votojnë)
- Berat Luzha dhe Besa Gaxherri;
(Votojnë)
- Le të bëhen gati Bislim Hoti. Bogdanoviq Goran nuk është. Dhe Brikenda Kryeziu.
(Votojnë)
- Le të bëhen gati Bujar Dugolli dhe Demir Lima.
(Votojnë)
- Le të përgatiten Drita Statovci dhe Emin Krasniqi.
(Votojnë)
- Emrush Xhemajli dhe Enver Hoxhaj.
(Votojnë)
- Ethem Çeku dhe Fadil Gashi.
(Votojnë)
- Fadil Geci dhe Fadil Kryeziu.
(Votojnë)
- Fatmir Rexhepi dhe Fatmir Sejdiu.
(Votojnë)
- Fatmire Mulhaxha-Kollçaku dhe Fehmi Mujota. Meqenëse Fatmirja s'është, ftohen për votim:
- Fehmi Mujota dhe Fehmi Vula.
(Votojnë)
- Le të bëhen gati Fetah Berisha dhe Flora Brovina.
(Votojnë)
- Le të bëhen gati Gani Koci dhe Gazmend Muhaxheri. Gazmendi abstenon, por duhet ta ftojme. Atëherë, Genc Gorani. Edhe ky është nga Ora? Mirë. Le të bëhet gati Gjergj Dedaj.
(Votojnë)
- Gjylshen Berisha dhe Gjylnaze Sylja.
(Votojnë)
- Hajredin Hyseni dhe Hajredin Kuçi.
(Votojnë)
- Haki Shatri dhe Hashim Thaqi.
(Votojnë)
- Hatixhe Hoxha dhe Hydajet hyseni.
(Votojnë)

- Ibushi Rrustem, a është këtu?
- Ibrahim Rugova dhe Ibush Jonuzi.
(Votojnë)
 - Idrizi Sadik dhe Ilaz Pireva.
(Votojnë)
 - Iliq Sllagjan, mungon.
 - Ivanoviq Oliver, mungon.
 - Jakup Krasniqi dhe Januz Kastrati.
(Votojnë)
 - Jovanoviq Vesna, nuk është.
 - Jusuf Sutaj dhe Kamber Kamberi.
(Votojnë)
 - Kolë Berisha dhe... Kërstoviq Dragisha nuk është, Kujunxhiq Zllatica nuk është.
 - Kolë Berisha dhe Lulzim zeneli.
(Votojnë)
 - Lumnije Hyseni dhe Lutfi Zharku.
(Votojnë)
 - Mahir Jaghillar dhe Mark Krasniqi.
(Votojnë)
 - Melihate Tërmkolli dhe Milazim Haliti.
(Votojnë)
 - Miliçiq Snezhana, nuk është.
 - Murati Xhezair dhe Murati Shpresa.
(Votojnë)
 - Myrvete Baliu – Dreshaj dhe Nafije Berisha.
(Votojnë)
 - Naim Jerliu dhe Naim Maloku.
(Votojnë)
 - Nait Hasani dhe Naser Osmani.
(Votojnë)
 - Naxhije Doçi dhe Nazim Jashari. Nazim Jashari qenka i Orës, më falni.
Atëherë, Naxhije Doçi dhe Nekibe Kelmendi.
(Votojnë)
 - Nerxhivane Dauti dhe Nexhat Daci.
(Votojnë)

NË VIJIM, SEANCËN E KRYESON NAIM MALOKU, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS

NAIM MALOKU:

- Nexhat Rexha dhe Nimon Alimusaj.
(Votojnë)
- Nojkiq Rangjell, nuk është.
- Nuran Malta dhe Nurishahe Hulaj.
(Votojnë)
- Petkoviq Sllavisha, nuk është.
- Qibrije Hoxha dhe Ragip Zekolli.
(Votojnë)
- Ramadan Kelmendi dhe Ramadan Musliu.
(Votojnë)
- Ramë Buja, Ramush Haradinaj.
(Votojnë)
- Remzije Nimani dhe Rifat Krasniq. Rifat Krasniq nuk është, a? (Nuk vërtetohet)
(Votojnë)
- Rudina Bukoshi dhe Sabit Rrahmani.
(Votojnë)
- Sabri Hamiti dhe Safete Hadërgjonaj.
(Votojnë)
- Sala Ahmetaj dhe Sala Shala.
(Votojnë)
- Samije Zeqiraj dhe Sanije Alijaj.
(Votojnë)
- Saviq Gojko, nuk është.
- Selvije Halimi dhe Sokol Bashota.
(Votojnë)
- Sylejman Çerkezi dhe Shaban Halimi.
(Votojnë)
- Teuta Hadri dhe Teuta Sahatçia. Kjo është nga Ora, a? Veton Surroi. Edhe ky nga Ora.
- Atëherë Teuta Hadri dhe Xhavit Haliti.
(Votojnë)
- Xhelal Canziba dhe Xhevdet Neziraj.
(Votojnë)
- Ylber Hysa, nuk është.
- Ymer Muhaxheri dhe Zahrije Jusufi.
(Votojnë)
- Zef Morina dhe Zyhrije Maloku.
(Votojnë)
- Zylfi Merxha dhe Zylfije Hundozi.
(Votojnë)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Me këta deputetë përfundon votimi. Ju lutemi të jeni të gatshëm për numërim dhe monitorim. Për vërejtje tjetër herë, kemi hyrë në procedurë.

Nuk kam asgjë kundër përmbajtjes që thoni, por t'i shohim rezultatet dhe të ecim më tej.

Monitoruesit, të mos përzihen! Mund të shikojnë vetëm se a është çdo gjë në rregull, apo jo.

Më lejoni t'i shpalli rezultatet e votimi.

Të pranishëm kanë qenë 108 deputetë. Fletëvotimin e kanë marrë 100 deputetë.

Për doktor Ibrahim Rugovën kanë votuar 65 deputetë;

Për Ramë Bujën kanë votuar 34 deputetë.

Të pavlefshme – një fletëvotim.

Sipas këtij rezultati, procedura e votimit duhet të përsëritet konform Kreut 9.2.8 të Kornizës kushtetuese dhe Rregullës 14.5 të Rregullores së punës të Kuvendit.

Prandaj, fillojmë menjëherë votimin e dytë, sipas të njëjtës procedurë. Ju lutem a jeni gati teknikisht?

Ju lutem, po vazhdojmë. Procedura është e njëjtë, prandaj mund të monitoroni, e drejtë juaja është.

- Afrim Arzullaxhiu dhe Agim Krasniqi.
(Votojnë)
Le të bëhen gati:
- Ahmet Isufi dhe Alush Gashi.
(Votojnë)
- Bajram Kosumi dhe Bajram Rexhepi.
(Votojnë)
- Bajrush Xhemali dhe Behxhet Brajshori.
(Votojnë)
- Berat Luzha dhe Besa Gaxherri;
(Votojnë)
- Bislim Hoti dhe Brikenda Kryeziu.
(Votojnë)
- Bujar Dugolli dhe Demir Lima.
(Votojnë)

- Drita Statovci dhe Emin Krasniqi.
(Votojnë)
- Emrush Xhemajli dhe Enver Hoxhaj.
(Votojnë)
- Ethem Çeku dhe Fadil Gashi.
(Votojnë)
- Fadil Geci dhe Fadil Kryeziu.
(Votojnë)
- Fatmir Rexhepi dhe Fatmir Sejdiu.
(Votojnë)
- Fehmi Mujota dhe Fehmi Vula.
(Votojnë)
- Fetah Berisha dhe Flora Brovina.
(Votojnë)
- Gani Koci dhe Gjergj Dedaj.
(Votojnë)
- Gjylshen Berisha dhe Gjylnaze Syla.
(Votojnë)
- Hajredin Hyseni dhe Hajredin Kuçi.
(Votojnë)
- Haki Shatri dhe Hashim Thaqi.
(Votojnë)
- Hatixhe Hoxha dhe Hydajet Hyseni.
(Votojnë)
- Ibrahim Rugova dhe Ibush Jonuzi.
(Votojnë)
- Idrizi Sadik dhe Ilaz Pireva.
(Votojnë)
- Jakup Krasniqi dhe Januz Kastrati.
(Votojnë)
- Jusuf Sutaj dhe Kamber Kamberi.
(Votojnë)
- Kolë Berisha dhe Lulzim Zeneli.
(Votojnë)
- Lumnije Hyseni dhe Lutfi Zharku.
(Votojnë)
- Mahir Jaghillar dhe Mark Krasniqi.
(Votojnë)
- Melihate Tërmkolli dhe Milazim Haliti.
(Votojnë)
- Murati Xhezair dhe Murati Shpresa.
(Votojnë)
- Myrvete Baliu dhe Nafije Berisha.
(Votojnë)

- Naim Jerliu dhe Naim Maloku.
(Votojnë)
- Nait Hasani dhe Naser Osmani.
(Votojnë)
- Naxhije Doçi dhe Nekibe Kelmendi.
(Votojnë)
- Nerxhivane Dauti dhe Nexhat Daci.
(Votojnë)

NË VIJIM, SEANCËN E KRYESON NAIM MALOKU, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS

NAIM MALOKU:

- Nexhat Rexha dhe Nimon Alimusaj.
(Votojnë)
- Nuran Malta dhe Nurishahe Hulaj.
(Votojnë)
- Qibrije Hoxha dhe Ragip Zekolli.
(Votojnë)
- Ramadan Kelmendi dhe Ramadan Musliu.
(Votojnë)
- Ramë Buja, Ramush Haradinaj.
(Votojnë)
- Remzije Nimani dhe Rifat Krasniq.
(Votojnë)
- Rudina Bukoshi dhe Sabit Rrahmani.
(Votojnë)
- Sabri Hamiti dhe Safete Hadërgjonaj.
(Votojnë)
- Sala Ahmetaj dhe Sala Shala.
(Votojnë)
- Samije Zeqiraj dhe Sanije Alijaj.
(Votojnë)
- Selvije Halimi dhe Sokol Bashota.
(Votojnë)
- Sylejman Çerkezi dhe Shaban Halimi.
(Votojnë)
- Teuta Hadri dhe Xhavit Haliti.
(Votojnë)
- Xhelal Canziba dhe Xhevdet Neziraj.
(Votojnë)
- Ymer Muxaxheri dhe Zahrije Jusufi.
(Votojnë)

- Zef Morina dhe Zyhrije Maloku.
(Votojnë), dhe:
- Zylfi Merxha dhe Zylfije Hundozi.
(Votojnë)

Me kaq, përfundon rrethi i dytë i votimit. Lutem Komisioni i votimit dhe monitorët ta kryejnë punën e vet.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem për vëmendjen tuaj. Tani po shpallim rezultatet e votimit të dytë. Në votim kanë marrë pjesë 100 deputetë.

Për doktor Ibrahim Rugovën kanë votuar 63 deputetë.

Për Ramë Bujën kanë votuar 34 deputetë.

Të pavlefshme janë tre fletëvotime.

Prezent janë 106 deputetë.

Tani teknika le të përgatitet për votimin e tretë.

Urdhëroni. E ka fjalën Jakup Krasniqi, shef i Grupit Parlamentar të PDK.

JAKUP KRASNIQI:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Partia Demokratike e Kosovës tërheq kandidatin e saj nga votimi i tretë dhe kërkon që të bëhet ndryshim në listë dhe, përveç emrit të kryetarit Rugova të shënohen „për“, „kundër“ dhe „abstenim“.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirë, le të respektohet kërkesa. Le të përgatitet listë e re me vetëm një kandidat dhe votimet „për“, „kundër“, kurse „abstenim“ nuk ka sipas procedurës.

Pauzë nuk do të bëjmë deri në përfundimin e rendit të ditës, ju lutem.

A jeni gati teknika? A kemi listën vetëm me një kandidat të propozuar? E kemi. Atëherë vazhdojmë me votimin.

Ju lutem, teknika le ta kontrollojë që të jetë vetëm një emër në fletëvotim dhe vetëm „për“ e „kundër“. Çdo fletëvotim tjetër, që lëshon teknika, është përgjegjëse Sekretaria.

(Ndërprerje)

- Afrim Arzullaxhiu dhe Agim Krasniqi.
(Votojnë)
- Ahmet Isufi dhe Alush Gashi.
(Votojnë)
- Bajram Kosumi dhe Bajram Rexhepi.
(Votojnë)
- Bajrush Xhemali dhe Behxhet Brajshori.
(Votojnë)
- Berat Luzha, Besa Gaxherri dhe Bislim Hoti.
(Votojnë)
- Le të bëhen gati Brikenda Kryeziu dhe Bujar Dugolli.

Po, kemi hyrë në proces, të lutem! Nuk guxojmë, kemi hyrë në procedurë.

- Demir Lima dhe Drita Statovci.

(Ndërhyrje)

Po, unë - po ju thërras, kryetar i PDK! Jo more, me emër po ju thërras! Kurgjo s'po ndryshoj. Jam n'dakord dhe në rregull është. Veç ta kryejnë këta që janë në proces dhe ju ftoj pastaj prej fillimit. Nuk bën shefi i Grupit Parlamentar, ju jeni kryesori. Mirë, do të veprojmë si thotë kryetari i Partisë.

- Afrim Arzullaxhiu dhe Bajram Rexhepi.
(Votojnë)
- Bajrush Xhemajli dhe Berat Luzha.
(Votojnë)
- Demir Lima, le të bëhet gati.
(Voton)
- Drita Statovci dhe Emin Krasniqi.
(Votojnë)
- Emrush Xhemajli dhe Enver Hoxhaj.
(Votojnë)
- Ethem Çeku dhe Fadil Gashi.
(Votojnë)
- Fadil Geci dhe Fadil Kryeziu.
(Votojnë)
- Fatmir Rexhepi dhe Fatmir Sejdiu.
(Votojnë)
- Fehmi Mujota dhe Fehmi Vula.
(Votojnë)
- Fetah Berisha dhe Flora Brovina.
(Votojnë)

- Gani Koci dhe Gjergj Dedaj.
(Votojnë)
- Gjylshen Berisha dhe Gjylnaze Syla.
(Votojnë)
- Hajredin Hyseni dhe Hajredin Kuçi.
(Votojnë)
- Haki Shatri dhe Hashim Thaqi.
(Votojnë)
- Hatixhe Hoxha dhe Hydajet Hyseni.
(Votojnë)
- Ibrahim Rugova dhe Ibush Jonuzi.
(Votojnë)
- Idrizi Sadik dhe Ilaz Pireva.
(Votojnë)
- Jakup Krasniqi dhe Januz Kastrati.
(Votojnë)
- Jusuf Sutaj dhe Kamber Kamberi.
(Votojnë)
- Kolë Berisha dhe Lulzim Zeneli.
(Votojnë)
- Lumnije Hyseni dhe Lutfi Zharku.
(Votojnë)
- Mahir Jaghillar dhe Mark Krasniqi.
(Votojnë)
- Melihate Tërmkolli dhe Milazim Haliti.
(Votojnë)
- Murati Xhezair dhe Murati Shpresa.
(Votojnë)
- Myrvete Baliu dhe Nafije Berisha.
(Votojnë)
- Naim Jerliu dhe Naim Maloku.
(Votojnë)
- Nait Hasani dhe Naser Osmani.
(Voton)
- Naxhije Doçi, në vend të Nait Hasanit.
Nekibe Kelmendi dhe Nerxhivane Dauti.
(Votojnë)
- Nexhat Daci dhe Nexhat Rexha.
(Votojnë)

NË VIJIM, SEANCËN E KRYESON NAIM MALOKU, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT TË KOSOVËS

NAIM MALOKU:

Falemnderit.

- Nimon Alimusaj, Nuran Malta.
(Votojnë)
- Nurishahe Hulaj, Qibrije Hoxha.
(Votojnë)
- Ragip Zekolli dhe Ramadan Kelmendi.
(Votojnë)
- Ramadan Musliu dhe Ramë Buja.
(Votojnë)
- Ramush Haradinaj dhe Remzije Nimani.
(Votojnë)
- Rifat Krasniq, Rudina Bukoshi.
(Votojnë)
- Sabit Rrahmani, Sabri Hamiti.
(Votojnë)
- Safete Hadërgjonaj, Sala Ahmetaj.
(Votojnë)
- Sala Shala, Samije Zeqiraj.
(Votojnë)
- Sanije Alijaj, Selvije Halimi.
(Votojnë)
- Sokol Bashota dhe Sylejman Çerkezi.
(Votojnë)
- Shaban Halimi, Teuta Hadri.
(Votojnë)
- Xhavit Haliti, Xhelal Canziba.
(Votojnë)
- Xhevdet Neziraj, Ymer Muhaxheri.
(Votojnë)
- Zahrije Jusufi, Zef Morina.
(Votojnë)
- Zyhrije Maloku, Zylfi Merxha,
(Votojnë)
- Dhe e fundit Zylfije Hundozi.
(Voton)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Votimi u krye. Ju lutem të kryhet procesi i numërimit të votave.

Më lejoni ta kumtoj rezultatin e votimit të tretë dhe përfundimtar.

Në votim kanë marrë pjesë 99 deputetë:

Për - kanë votuar 64 deputetë;

Kundër - kanë votuar 32 deputetë.

(Duartrokitje)

Ta përfundoj, ju lutem.

Të pavalershme janë 3 fletëvotime.

Prandaj, në emër të Kryesisë dhe të kryetarit të Parlamentit, në emrin tuaj zotri deputetë, e përgëzoj presidentin e gjertanishëm dhe të ardhshëm doktor Rugovën dhe e lus për një fjalë përshëndetëse t'iu drejtohet deputetëve.

Fjala është e juaja zoti president.

PREZIDENTI IBRAHIM RUGOVA:

I nderuari kryetar Daci, deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,
Ju falënderoj për besimin e dhënë që edhe në mandatin e ardhëm të udhëheq vendin tonë të dashur Kosovën në cilësinë e presidentit.

Të nderuar deputetë,

Betohem solemnisht se do ta ruaj e mbroj integritetin territorial të vendit tonë – Kosovës dhe unitetin e popullit, do të angazhohem për zhvillimin ekonomik dhe demokratik, për stabilitetin, prosperitetin dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve, do të punoj për njohjen sa më të shpejtë të pavarësisë dhe të integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian e në NATO, si dhe për forcimin e miqësisë permanente me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Zonja dhe zotrinj,

Më lejoni që nga kjo Seancë përuruese solemne të Kuvendit të Kosovës të përshëndes Presidentin Bush, Kryeministrin Bler, Presidentin Shirak, Kancelarin Shroder, Kryeministrin Berlusconi dhe Sekretarin gjeneral Anan që po e përkrahin Kosovën.

Si gjithmonë, përshëndetje të ngrohta i dërgoj atit të shenjt Papa Gjon Palit II, që gjithmonë kujdeset për Kosovën.

Zoti ju bekoftë! Zoti e bekoftë Kosovën! Ju falemnderit.

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Dhe, pika përfundimtare e Seancës është zgjedhja e kryeministrit të Kosovës dhe e ministrave të kësaj Qeverie.

Në bazë të marrëveshjes së partive partnere në koalicion, si dhe në pajtim me Kreun 9.3.8 dhe 9.3.9 të Kornizës kushtetuese, ftoj kryetarin e Kosovës, zotin Rugova që ta bëjë propozimin e kandidatit për kryeministër të Kosovës. Unë e kam të njohur këtë, por është procedurë dhe - ju lutem, zoti president ta merrni fjalën.

PREZIDENTI IBRAHIM RUGOVA:

V E N D I M

Në bazë të komptencave kushtetuese dhe në bazë të marrëveshjes së koalicionit në mes të LDK, AAK dhe partnerëve tjerë të koalicionit, kam vendosur ta nominoj zotin Ramush Haradinaj për Kryeministër të Qeverisë së Kosovës, dhe lidhur me këtë edhe kam kërkuar nga kryeministri i nominuar që ta formojë Qeverinë në bazë të marrëveshjes së koalicionit. Ju falemnderit. Urime.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ftoj kandidatin e propozuar për Kryeministër të Kosovës zotin Haradinaj që ta paraqesë listën e ministrave të propozuar.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:

Zoti kryetar, i nderuar zoti president Rugova,
Ju falemnderit për besimin. Në bazë të marrëveshjes së koalicionit dhe të kërkesës nga nominimi, unë kam marrë përsipër ta bëj kompletimin e Qeverisë së Kosovës me ministrat, si vijon:

- për Zëvendëskryeministër zotri Adem Salihaj, i cili është sot prezent me ne;
- për Ministër të ekonomisë dhe financave është zotri Haki Shatri, me profesion ekonomist;

- Ministër i shërbimeve publike është zonjusha Melihate Tërmkolli, me profesion juriste;
- Ministër i pushtetit lokal zotri Lutfi Haziri, me profesion drejtimi i shkencave matematiko-natyrore;
- Ministër i transportit dhe telekomunikacionit, zotri Qemajl Ahmeti, me profesion inxhinier i elektroteknikës;
- Ministër i arsimit, shkencës dhe teknologjisë zotri Agim Veliu, me profesion jurist;
- Ministër i kulturës zotri Astrit Haraçia, po ashtu shkencat e drejtësisë;
- Ministër i mbrojtjes së ambientit dhe të planifikimit hapsinor zotri Bajram Kosumi, me profesion magjistër i letërsisë së gjuhës shqipe;
- Ministër i energjetikës dhe minierave zotri Ethem Çeku, me profesion magjistër i historisë;
- Ministër i punës dhe mirëqenies sociale zotri Ahmet Isufi, profesioni gjuhë dhe letërsi;
- Ministër i industrisë dhe tregtisë zotri Bujar Dugolli, me profesion historian – magjistër;
- Ministër i shëndetësisë është zotri Sadik Idrizi, filolog.

Po ashtu, më lejoni ta informoj Parlamentin se dy ministritë janë paraparë të udhëheqen nga serbët e Kosovës. Meqenëse ministrat ende nuk janë nominuar, ne kemi paraparë emërimin e zëvendësve dhe në një seancë të radhës, Parlamenti do të ketë mundësinë po ashtu të njihet me zëvendësit tjerë.

Zoti kryetar,

Në bazë të obligimit, unë kam para veti edhe Programin e Qeverisë së Kosovës si propozim. Po ashtu, kam edhe një ekspozë lidhur me Programin, të përgatitur me këtë rast, por në bazë të procedurës unë do t'i përgjigjem kërkesës tuaj.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Zoti Kryeministër, ose kandidat për kryeministër, ju falemnderit shumë.
Tani ftoj deputetët që me votim të zakonshëm...

(Pas ndërhyrjes)

...Jemi në procedurë të votimit, zoti shef. Për këtë keni kohë...

Ftoj deputetët që të votojmë për kryeministrin dhe Qeverinë e propozuar.
Kush është për? Ju lus, t'i numëroni votat.

Zoti shef, le ta kryejmë njëherit procedurën. Unë i di shumë mirë dhe të drejtat ua rrespektoj. Thash, kemi hyrë në procedurë të procesit të votimit. Pa u përfunduar ky proces, nuk ka mundësi për asnjë fjalë a diçka tjetër.

(Meqë e ka mikrofonin afër, dëgjohet bashkëkresuesi: Janë 72 „për“)...

Ju falemnderit.

Kush është kundër?

Le të numërohen votat „kundër“ për Kryeministrin dhe kabinetin e propozuar të tij. Ju falemnderit.

A ka abstenime?

(Bashkëkryesuesi: 5 „abstenime“)...

Më lejoni t'ju njoftoj.

72 deputetë të pranishëm kanë votuar për kabinetin e Kryeminsitrit Haradinaj...

(Duartrokitje)

2 deputetë janë kundër, dhe 5 të tjerë kanë abstenuar.

Po, zoti shef, do t'ua jap fjalën, por ta kryej njëher.

T'ju informoj se do t'ju ftoj në një seancë tjetër kur Kryeministri do të paraqesë Programin e Qeverisë dhe për të do të diskutohet. Nëse e keni lidhur me këtë, këtë ta bëni në atë seancë. Megjithatë, jeni shef i Grupit. Urdhëroni.

Lus deputetët të ulën, seanca nuk ka përfunduar dhe ta dëgjojmë shefin e Grupit Parlamentar.

JAKUP KRASNIQI:

Zonja dhe zotrinj,

Ne, demokratët e Kosovës, me vëmendje të shtuar kemi përcjellur sidomos përbërjen e kabinetit të Qeverisë së re të Kosovës. Edhe pse kemi qenë për një koalicion më të gjerë, që arsyetimin e dha kohë më parë kryetari ynë, ne si Parti politike kemi pranuar të jemi të gatshëm për një opozitë dhe opozitë e fuqishme për avancimin e procesit politik, por nuk do të hezitojmë të denoncojmë çdo paligjsi, paaftësi, fudullëk të institucioneve në përgjithësi, e të Qeverisë – në veçanti, që mund të ndodhin.

Ju, koalicionin qeverisës e keni bërë për interesa tuaja klanore. Nuk keni patur parasysh pozicionin e Kosovës – pa statusin shtet të pavarur të Kosovës. Nuk keni patur parasysh stabilitetin politik, ekonomik, sigurinë dhe problemet e ndryshme sociale – për çka keni marrë një përgjegjësi të madhe.

Ne kuptojmë interesin tuaj, prandaj kërkojmë nga ju që të kuptoni drejt rolin e opozitës dhe kërkesat tona opozitare. Ju e dini se ne jemi mësuar të jemi kujdestar të padrejtësive dhe të paligjsive saherë që ka ndodh kjo në Kosovë.

Detyra jonë është të jemi kujdestar për t'i fokusuar gabimet tuaja të djeshme, të sotme dhe të ardhshme. Problemeve dhe interesave të Kosovës do t'i qasemi me përkushtim, profesionalizëm e vendosmëri. Do të denoncojmë çdo shkelje ligjore e financiare, çdo gabim politik e paaftësi në qeverisje.

Ne i kuptojmë vështirësitë profesionale e politike të Kryeministrit të ri. E kuptojmë presionin dhe denoncimet që i janë bërë që sa vite nga kundërshtarët e tij politik – tani aleat, si dhe presionin e padrejtë që bën Tribunali i Hagës - dhe jo vetëm atij – në bashkërendim me strukturat e vjetra e të reja serbe, por kjo nuk na pengon t'i shfaqim rezervat tona për kabinetin e tij. E kuptojmë se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk ka mund të ofrojë një ekipë tjetër më profesionale; ka ofruar fytyrat e saj politike që së paku nuk janë figura të panjohura politike, por nuk mund të kuptojmë aleatin e saj të koalicionit – LDK-ën - të cilës nuk i mungojnë kuadrot e kualifikuara, intelektualët e profesionistët, për të cilët ka folur shumë gjatë fushatës zgjedhore. Ku iu avulluan intelektualët dhe profesionistët e shumtë? Pse del kaq e varfër me intelektual e profesionist? Ajo jo vetëm që ka ofruar kuadër të pakualifikuar, mendoj në përjashtim të parëndësishëm, por ka ofruar kuadro që janë shquar në këtë qeverisje lokale, ka ofruar kuadro që kanë qenë konfliktuoz, të paaftë dhe keqpërdorues të pozitive që kanë mbajtur nëpër komuna prejnga ata vijnë.

Viti 2005 - ka kohë që është pritur të jetë viti i një kthese të madhe, i ndryshimeve të mëdha, viti i energjive dhe i përgjegjësive të mëdha.

Unë ju pyes sinqerisht, zonja e zotrinj deputetë, Qeveria e ofruar – a i posedon kualitetet profesionale, politike dhe intelektuale që i duhen Kosovës sot? Unë nuk kërkoj përgjegje nga ju. Përgjigjuni ndërgjegjes tuaj në raport me proceset që kemi përpara. Mendoni edhe për të ardhmen e fëmijëve tuaj.

Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, në emër të të cilës po flas, nuk paragjykoj, por po flas për shqetësimet tona pasi që ne jemi më shumë se të shqetësuar për fatin e procesit politik, për fatin e zhvillimit ekonomik, për sigurinë dhe drejtësinë, për të ardhmen e fëmijëve tanë.

Këta njerëz, nuk i kanë kualitetet morale, politike, intelektuale, profesionale e as atdhetare për të qeverisur me Kosovën, me status të padefinuar politik. Kemi frikën se këta njerëz janë zgjedhur nga grupe joformale për ta kriminalizuar jetën politike dhe ekonomike në tri vitet e ardhshme në Kosovë. Kemi frikë se ky formacion qeverisës do ta izolojë edhe më shumë Kosovën edhe ashtu të copëtuar dhe të izoluar. Këtij formacioni qeverisës nuk ia kemi besën se do t'i relaksojë as marrëdhëniet njerëzore në Kosovë. Kur e them këtë, kemi parasysh raportet tepër të çrregulluara që sjellin këta kandidatë nga komunat prej të cilave vijnë.

Dëshira ime është që në tri vitet e ardhshme të ndodhë e kundërta e kësaj që po e them sot në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, por problemet e Kosovës nuk zgjidhen vetëm me vullnet e dëshira të mira. Problemi i Kosovës nuk është problem formal.

Partia Demokratike e Kosovës ka rrespekt të madh për rolin e familjes Haradinaj në luftën çlirimtare, për flijimet e saj për Kosovën, por ne – për hirë të Kosovës – jemi të detyruar të mos e votojmë Qeverinë e Ramushit. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem, për përfundim. Zoti Krasniqi, sot keni thënë ç'keni dashur. Keni denoncuar, keni përdorur çdo fjalor të mundshëm. Dhe, sot kemi provuar, ashtu siç e tha edhe kryetari juaj - ta kemi demokracinë e plotë në veprim.

Dhe, unë po ju premtoj, në qoftë se e vazhdoni kështu, e unë i udhëheqi seancat – nuk do të ketë përsëritje të gjërave të këtilla. Ju falemnderit të gjithëve, edhe juve, për pjesëmarrje.

Seanca përfundoi punën në orën 15,15.

Shënim: Shenjat e interpunkcionit të paraqitura në transkript kanë këtë domethënie:

- “.....” ----- - nuk kuptohet se ç'ka dashur të thotë diskutuesi;
- “...” ----- - nuk përfundon fjalën ose fjalinë diskutuesi;
- “Pa kyçje të mikrofonit” ----- - diskutuesi nuk kyç mikrofonin;
- “Ndërhyrje” ----- - ndërhyrje – pa kyçje të mikrofonit;
- “Ndërprerje” ----- - ndërpritet toni, nuk transkriptohet.

E transkriptoi: RT, zyra E-04, tel.dir.038-211-860, lok.10-508 rtullari@hotmail.com